DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË:

RREGULLOREN NR.27, DATË 21.09.2012

“MBI PUBLIKIMIN E INFORMACIONIT PËR TARIFAT SI DHE KUSHTET E AKSESIT DHE PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE”

Dokumenti Përfundimtar

(Miratuar me VKD nr.37, datë 18.05.2018)

<u>Në nenin 6 të rregullores "Lloji dhe përmbajta e informacionit"</u> shtohen përcaktimet e mëposhtëme:

- Pika "*11". Sipërmarrësit duhet të publikojnë dhe të vënë në dispozicion të pajtimtarëve informacionin e plotë mbi cilësitë e shërbimit sipas nenit 102 të Ligjit*.
- Në pikën e re "12" (zhvendosur pas shtimit të pikës së mësipërme) u shtua germa *g. sipërmarrësit duhet të vendosin në mënyrë të dukshme kontaktet e AKEP: Adresa: Rr. "Reshit Çollaku", Nr. 43, Tiranë, Tel:+355 4 2259 571, ëëë.akep.al, Fax: +355 4 2259 106, info@akep.al dhe formularët për ankesa për mosmarrëveshjeve për pajtimtarët*.

<u>Neni 8 i rregullores ndryshohet si vijon:</u>

Ishte:

Neni 8

Detyrimi për informimin e AKEP

Sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi mënyrën e publikimit të tarifave dhe shërbimeve, dhe çdo ndryshim të tyre:

a. duke dhënë linkun përkatës në faqen e Internetit se ku janë publikuar tarifat dhe informacioni për to;
b. duke përfshirë fletëpalosjet përkatëse të programit të ri tarifor;
c. mjetet e informimit publik ku është bërë njoftimi i tyre

Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, jo më vonë se 3 ditë pas bërjes efektive të tarifave/ndryshimeve.

Forma e dërgimit të të dhënave në rrugë elektronike do të jetë e disponueshme në faqen e internetit të AKEP.

Sipërmarrësit, të cilëve AKEP u ka vendosur detyrime të veçanta për tarifat me pakicë, duhet të aplikojnë afatet dhe rregullat e përcaktuara nga AKEP në mënyrë specifike.

Bëhet:

Neni 8

Detyrimi për njoftimin e pajtimtarëve, publikimin e tarifave dhe informimin e AKEP

1. Sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre me arsyetimet mbështetëse, jo më vonë se 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave ose ndryshimeve të tyre.

2. Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore. Forma e dërgimit të të dhënave në rrugë elektronike do të jetë e disponueshme edhe në faqen e internetit të AKEP.

3. AKEP-i publikon vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale sipas përcaktimeve të nenit 12 te kësaj rregulloreje.

4. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftojnë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më pak se 3 ditë rresht;

5. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t'ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit sipas nenit 98 pika 5 te Ligjit.

6. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të njoftojnë pajtimtarët për çdo modifikim në kushtet e kontratave për jo më pak se 30 ditë përpara në përputhje me nenin 99 pika 3 të Ligjit.

7. Sipërmarrësit, të cilëve AKEP ka vendosur detyrime të veçanta për tarifat me pakicë, duhet të aplikojnë afatet dhe rregullat e përcaktuara nga AKEP në mënyrë specifike.

8. Përcaktimet e mësipërme janë të detyrueshme për tu zbatuar për të gjitha paketat e shërbimeve, me parapagesë ose me pas-pagesë, paketa standarde, oferta, etj.

9. Në mënyrë grafike afatet për njoftimin e pajtimtarëve, publikimin dhe njoftimin e AKEP janë në aneksin 1.

Ndryshimet e mësipërme, u reflektuan edhe në rregulloren Nr.27, datë 21.09.2012, e cila do të publikohet së bashku me vendimin e Këshillit Drejtues.

Në Rregullore nr.27 shtohet Aneks 1 si vijon: